



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 258/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Prishtinë, paraqitur kundër subjekti Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Podujevë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me dt. 12.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 08.06.2014, nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Prishtinë me të cilën pretendohet se me datën 08.06.2014, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) është thyer heshtja zgjedhore ku në Qendrën e votimit në shkollën “Isa Boletini” në Komunën e Podujevës, komisionari Isa Jakupi i subjektit politik të lartpërmendur, në ambientet e shkollës ku është Qendra e votimit ka ekspozuar logo të LDK-së.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik- Lidhjen Demokratike të Kosovës -, me datën 09.06.2014, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 10.06.2014 deri në ora 09:00.

PZAP-i, pranoi përgjigjen në ankesë sipas afatit të caktuar

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Me ankesën e parashtruar nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës pretendohet se, në Qendrën e votimit komisioneri Isa Jakupi ka ekspozuar logo të LDK-së në ditën e Zgjedhjeve më datë 08.06.2014.

PZAP-i, gjeti se pretendimet e tilla ankimore nuk qëndrojnë, ngase pohimet e lartcekura nga parashtruesi i ankesës nuk janë objektive, për arsye se nuk është ofruar asnjë dëshmi me të cilën do të vërtetohej një pretendim i tillë ankimorë, shikuar sipas dispozitës së nenit 3.6 pika c) e Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it .

PZAP-i, konstatoi se një pretendim i tillë është i përgjithshëm dhe i pa qartë për tu administruar si provë relevante prandaj ankesa vlerësohet si e pa bazë duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa në Prishtinë

Anr.258/2014 më datën 12.06.2014



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*